FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

KLORUR KALCIUMI

Tretësirë për injeksion - 1000 mg / 10 ml
(Klorur kalçiumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Klorur kalciumi dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Klorur kalciumi
3. Si ta merrni Klorur kalciumi
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Klorur kalciumi
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KLORUR KALCIUMI DHE PËRSE PËRDORET

Kalçiumi është një element mineral i domosdoshëm për ruajtjen e barazpeshës elektrolitike dhe për funksionimin e duhur të shumë mekanizmave rregullatore.
Pamjaftueshmëria e kalçiumit shoqërohet me çrregullime neuromuskulore dhe çmineralizimin e kockave.
Marrja e kalçiumit e rrit përqëndrimin e tij në serum dhe në të gjithë organizmin. 99% e kalçiumit në organizëm është e lidhur me fosfatet në kocka, kryesisht si hidroksiapatit.

Indikohet në:

- pamjaftueshmëri kalçiumi (spazmofili, tetani, mjekim ndihmës në rakit, osteomalaci, osteoporozë, gjatë shërimit të frakturave);
- sëmundje alergjike (sëmundje e serumit, shok anafilaktik, urtikarie, edemë angioneurotike);
- sëmundje infektive kronike;
- ekzemë eksudative;
- mjekim ndihmës në trajtimin e pickimeve nga insektet.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Klorur kalciumi për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI KLORUR KALCIUMI

Mos përdorni Klorur kalciumi në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj barit;
- keni hiperkalçemi (p.sh. në hiperparatiroidizëm, mbidozim i vitaminës D, tumore që shkaktojnë dekalçifikim p.sh. plazmacitoma, metastazat e kockave);
- keni hiperkalçiuri të rëndë;
- keni insufiçiencë të rëndë renale;
- keni sindrom Zollinger – Ellison;
- mjekoheni me digitalikë.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, këshillohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Klorur kalciumi
Tretësira e klorurit të kalçiumit është irrituese dhe duhet treguar kujdes për të parandaluar daljen nga vena gjatë injektimit në të.
Kripërat e kalçiumit duhen përdorur me kujdes në të sëmurët me dëmtime të funksionit të veshkave (nuk duhen përdorur në dëmtimin e rëndë të funksionit të tyre) ose në sëmundjet që shoqërohen me rritjen e përqëndrimit të vitaminës D, siç është sarkoidoza.
Përveç kësaj, ato duhen mënjanuar në të sëmurët me kalkula renale ose me të dhëna për kalkula renale.
Kloruri i kalçiumit, për shkak të natyrës së tij acidifikuese është i papërshtatshëm për trajtimin e hipokalçemisë së shkaktuar nga insufiçienca renale ose për të sëmurët me acidozë respiratore apo me insufiçiencë respiratore.
Përqëndrimet plazmatike të kalçiumit duhen mbikqyrur me kujdes në të sëmurët me insufiçiencë renale dhe kur në të njëjtën kohë merren edhe doza të larta të vitaminës D.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Klorur kalciumi.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë edhe ato të marra pa recetë.
Kur kripërat e kalçiumit përdoren njëherësh me diuretikët tiazidikë ose vitaminën D, mund të shfaqet hiperkalçemi.
Kalçiumi i rrit efektet e glikozideve digitalike në zemër dhe mund të shkaktojë helmim nga digitali; është mirë që gjatë mjekimit me glikozide digitalike të mënjanohet marrja e kalçiumit me injeksion.
Kripërat e kalçiumit e ulin përthithjen e një numri barnash, si: bifosfonateve, fluorureve, disa fluorokinoloneve dhe tetraciklinave.
Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit nëse njëkohësisht me Klorur kalciumi merrni edhe barnat e përmendura më sipër.

Marrja e Klorur kalciumi me ushqim dhe pije
Nuk aplikohet.

Shtatzënia
Kalçiumi e kalon placentën.
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gji
Kalçiumi kalon në qumështin e gjirit.
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë kësaj periudhe.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna.

3. SI TA MERRNI KLORUR KALCIUMI

Klorur kalciumi do t'ju administrohet shumë ngadalë në venë (i holluar paraprakisht) nga mjeku ose infermieri në spital. Tretësira është e pajtueshme me glukozë 5% dhe klorur natriumi 0.9%.
Mjeku juaj do të vendosë dozën e saktë për ju.

Në qoftë se keni marrë më shumë Klorur kalciumi
Në qoftë se keni marrë më shumë Klorur kalciumi se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Klorur kalciumi
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar!
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo.
Injektimi i kripërave të kalçiumit mund të shkaktojë irritim dhe injektimet intramuskulare ose subkutane në veçanti mund të shkaktojnë reaksione lokale, përfshirë dhe nekrozë të lëkurës.
Tretësirat e klorurit të kalçiumit janë tepër irrituese dhe nuk duhet të injektohen në muskul ose nën lëkurë.
Përdorimi i kripërave të kalçiumit në rrugë parenterale është shoqëruar me kalçifikim të indeve të buta.
Sasitë e tepërta të kripërave të kalçiumit mund të çojnë në hiperkalçemi.
Zakonisht, ky komplikacion ndodh pas administrimeve parenterale, por edhe pas marrjeve orale, kryesisht në pacientë me insufiçiencë renale ose tek ata të cilët marrin njëkohësisht vitaminë D.
Simptomat e hiperkalçemisë përfshijnë: anoreksi, nauze, të vjella, konstipacion, dhimbje abdominale, dobësi muskulare, shqetësime mendore, polidipsi, poliuri, nefrokalçinozë, kalkula renale dhe në raste të rënda, aritmi kardiake dhe koma.
Injektimi shumë i shpejtë intravenoz i kripërave të kalçiumit mund të çojë gjithashtu në hiperkalçemi, shije shkumësi në gojë, afshe të nxehta dhe vazodilatacion periferik.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të përmendura më sipër ju shqetëson.
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI KLORUR KALCIUMI

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Klorur kalciumi pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!
Kujdes! Ampula është vetëm për një përdorim.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Klorur kalciumi
Lënda vepruese është klorur kalçiumi.
Çdo ampulë 10 ml përmban 1000 mg klorur kalçiumi.
Përbërësit e tjerë: acid klorhidrik ose hidroksid natriumi mund të shtohet për rregullim pH, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 10 ampula.
Kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Merret vetëm me recetën e mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Tretësirë pë injeksion.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u formulua për herë të fundit në Dhjetor 2011.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.